



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

V E N D I M

Nr.39, date 22.07.2016

Për

**Dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së Z.Sokol Prendush Gjeka për dëmtim shtëpie nga zjarri**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ; Neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative; Ligji Nr.147/2015 datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”; pas shqyrtimit të projekt-vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Emergjencave Civile, Keshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 22.07.2016, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës me shumicë të cilësuar votash, për të përballuar dëmet e shkaktuara nga diegia e banesës e **Z. Sokol Prendush Gjeka** e përbërë nga **5** (pesë) anëtarë, nga fshati **Hoten** i Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau Dejës, e ndodhur me datë 08.07.2016,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare familjes së **Z. Sokol Prendush Gjeka** të përbërë nga **5** (pesë) anëtar, në shumën **10,000 (dhjetë mijë) lekë** për të përballuar dëmet e shtëpisë të shkaktuara nga rënia e zjarrit.
2. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i Bashkisë Vau Dejës për vitin 2016 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
5. U shpall sot me date 26/07/2016.

SEKRETARI  
Gentian NDOJ



KRYETARI  
Martin MARKU